



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 621/3 Prot.

Tiranë, më 30/6/2016

VENDIM  
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 40, datë 30/6/2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesit/S.K, E.K, E.B, G.K, L.B, A.B, B.B, L.I, A.T, M.T, B.H, F.H, F.H, M.D, H.M, A.M, A.Z dhe Znj. S N e cila është edhe përfaqësuese me prokurë të posaçme nr.rep 1565, nr. 794/2 kol datë 10.05.2016, kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 621/2 Prot., datë 07.06.2016, ndaj Autoritetit Publik/Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesit nëpërmjet përfaqësueses me prokurë Znj.N , me kërkesën nr. 8669 datë 09.05.2016 me objekt “Kërkesë për informacion/vënie në dispozicion të materialeve të kërkuara”, ka kërkuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike:

1. Kopje të urdhrin apo vendimit të organeve të shoqërisë për kryerjen e një ndërtimi dhe rikonstruksioni, të shoqëruar me relacionin përkatës që shoqëron nevojën dhe domosdoshmërinë e kryerjes së këtyre ndërtimeve;
2. Aktin nënligjor, urdhrin apo çdo lloj akti tjetër administrativ mbi bazën e të cilit kanë lindur tagrat e OSHEE për të ndërtuar dhe rikonstruktuar zyrat e administratës, çdo informacion apo akt mbi pronësinë ekzistuese apo të ardhshme mbi këto ndërtime;
3. Urdhrin e prokurimit përkatës si dhe çdo informacion dhe aktet përkatëse për procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, që janë kryer për llogari të autoritetit publik (OSHEE), duke përfshirë:
  - kontratën/listën e kontratave të lidhura;
  - shumën e kontraktuar;

- palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
  - informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave;
4. Lejen e ndërtimit, aplikimin përkatës për këtë leje, kushtet e saj si dhe lejet e tjera të nevojshme si leja mjedisore, etj;
  5. Komunikimin shkresor me organet e pushtetit qendror dhe vendor në lidhje me procedurat për kryerjen e këtyre punimeve;
  6. Informacion mbi pronësinë mbi truallin ku do të kryhen punimet, informacionin mbi objektet ekzistuese mbi këtë truall, gjendjen dhe vlerësimin e tyre, aktet e prishjes apo shembjes së tyre dhe gjithë procedurën e ndjekur në këtë drejtim;
  7. Çdo informacion apo akt që vërteton të drejtat e pronësisë apo të lindura nga ndonjë kontratë qiraje apo përdorimi të godinave ekzistuese që janë në proces rikonstruksioni;
  8. Informacion të hollësishëm mbi ecurinë e punimeve, afatin e fillimit dhe mbarimit të tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm mbi çështjen.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike rezulton se, Autoriteti Publik/ OSHEE nëpërmjet shkresës nr. 9875/1 Prot., datë 20.05.2016 i ka kthyer përgjigje kërkuessve duke e informuar se pyetjet e sipër cituara gjejnë përgjigje në VKM nr. 57 datë 21.01.2015 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të një objekti Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike".

Ankuesit e cituar në prokurën e posaçme nr.rep 1565, nr. 794/2 kol datë 10.05.2016, pretendojnë se janë çenuar në të drejtën për informim, pasi nuk janë informuar për të gjitha pikat e kërkesës dhe për këtë arsye kanë depozituar ankim në zyrën e Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në zbatim të nenit 24, pika 3 e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", me anë të e-mailit datë 21.06.2016, kërkoi nga ana e Operatorit i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të paraqesë parashtrime lidhur me kërkesën e ankuesve të përfaqësuar nga Znj.N . Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, me anë të e-mailit datë 27.06.2016, ka dërguar parashtrimet, ku informon Komisionerin se paralelisht me shqyrtimin administrativ të ankesës nga Zyra e Komisionerit, janë regjistruar dy kërkesë padi në gjykatën administrative konkretisht në datat 21 dhe 23 Qershor 2016. Këto padi lidhen drejtëpërdrejtë me kërkesën për informacion të datës 24.05.2016 të Znj. N .

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik/ Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka përmbushur detyrimin në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" duke i kthyer përgjigje kërkuessit brenda afateve ligjore. Gjithashtu bazuar në nenin 17 pika 2 gërma *dh* të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", e drejta e informimit në këtë rast kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë, barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e shtetasve të cituar në prokurën e posaçme nr.rep 1565, nr. 794/2 kol datë 10.05.2016, përfaqësuar nga Znj. N ndaj Zyrës Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 621/2 Prot., datë 07.06.2016 të ankuesve S.K, E.K, E.B, G.K, L.B, A.B, B.B, L.I, A.T, M.T, B.H, F.H, F.H, M.D, H.M, A.M, A.Z dhe Znj. S N e cila është edhe përfaqësuese me prokurë të posaçme nr.rep 1565, nr. 794/2 kol datë 10.05.2016, kundër Autoritetit Publik/ Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 30.06.2016.

